

PROCES VERBAL – Tipi i kontratës – PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky proces-verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot më datë: ____/____/2023, në mjediset e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Rajoni Elbasan sha, nga Njësia e Prokurimit, e ngritur me urdhrin e prokurimit nga administratori i shoqërisë me nr. 26, datë: 18. 04. 2023, me nr. 691 prot., në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën me të dhënat e mëposhtme:

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstrukcion dhe ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të zonave informale: Harmës; pjesërisht Krastë e Vogël, pjesërisht Lagjja: Dyli Haxhire” dhe, pjesërisht Lagjja: Katund i Ri”, vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): _____

VLERA E FONDIT LIMIT: 703 790 028 (shtatëqind e tre milion e shtatëqind e nëntë dhjetë mijë e njëzet e tetë) Lekë **pa TVSH**.

Argumentimi: Përlllogaritja e fondit limit të kontratës, është referuar në projektin e miratuar si dhe në preventivin e hartuar mbështetur në VKM nr. 629, datë: 15. 07. 2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Njësia e Prokurimit e autoritetit kontraktor UKRE sha, ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipër cituar duke u bazuar ne projektin e miratuar. Eshte bere ndarja e detyrave sipas fushes per secilin anetar te njesise, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetë-deklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë/dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 8)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 të LPP, nenin 39, pika 6/b të VKM nr. 285, datë: 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021, 2022** ku vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare **2020, 2021, 2022**, në përputhje me nenin 41 shkronja “c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, **nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 10091 date 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar. AK mund të kërkojë nga OE pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojë raportet nëpërmjet aktivitet dhe pasivitet. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve, është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë: 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 5, datë: 30. 01. 2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenin nr. 29, të ligjit nr. 8438, datë: 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: Çdo tatim-pagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatim-paguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Vlera e xhiros minimale vjetore e operatorëve ekonomikë, në përputhje me VKM nr. 285, datë: 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 2/a dhe 3, nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Shënim: Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë pranë AK, përpara publikimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga AK.

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është bazuar në nenin 43, pikat 2/a, 3 dhe 6, të VKM nr. 285, datë: 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2.4 OE duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit 9632, datë: 30. 10. 2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023.

Në rastet e bashkimit të OE, çdo anëtar i grupit BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse, ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023, sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim: OE për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetë-deklorojnë në formularin përmbledhës të vetë-deklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se i kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë: 30. 10. 2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë pranë AK, përpara publikimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë është bërë në përputhje në përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë: 30. 10. 2006 “Për sistemin e taksave vendore”! i ndryshuar, sipas të cilit, OE duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale për sa i përket aftësisë teknike e profesionale

2.3.1 OE, duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesë:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë **pesë** viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë **pesë** viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , në një vlerë jo më e vogël se **dyfishi** i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të OE do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore
- Aktin e kolaudimit;
- Akti i marrjes në dorëzim.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Në rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

b) Operatori Ekonomik, si dëshmi të përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore
- Aktin e kolaudimit;
- Akti i marrjes në dorëzim.

2.3.1/2 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve, shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i Bashkimit të Operatorëve.

2.3.1/3 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara

në të shkuarën. “Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 te VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. “Njësia përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Sipas këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacioneve ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së nr. 285 datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të kësaj VKM-je, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike, për të pasur mundësi të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktor edhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Meqenëse se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

2.3.2 Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

NP – 1 B	Punime gjurmimi në tokë
NP – 4 A	Rrugë autostrada mbikalime etj.
NP – 5 D	Punime nëntokësore, ura e vepra arti
NP – 7 F	Ujësjetësia, gazsjetësia, vajsjetësia, vepra kullimi dhe vaditje
NP – 12 E	Punime të inxhinierisë së mjedisit

Për punimet specifike të ndërtimit:

NS – 1 A	Punime për prishjen e ndërtimeve
NS – 18 C	Punime topografike
NS – 20 C	Shpime gjeologjiko-inxhinierike, puse e shpime për ujë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit 162, datë: 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, (lidhja 2,3 dhe 4).

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre sipas kategorive dhe niveleve (germave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Sipas VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008 të ndryshuar, kategoria **N.P-1 B** “Punime gjurmimi në tokë”: Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyre e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore. Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar: Kjo kategori është kërkuar duke pasur parasysh se parashikohen në preventiv punimet gjurmim dheu me krah dhe makineri, mbushje, ngjeshje, përforcime gjurmimi, mbushje kanali, sistemim të tokës etj., procese të cilat do të kryhen me qëllim shtrimin e tubacioneve të linjës kryesore dhe atë të shpërndarjes. Në preventiv janë parashikuar në total volume dhera të gjermuara me krahë, rreth 5855 m³ dhe, me makineri rreth 61855 m³, të cilat konkretisht karakterizohen nga gjurmim dheu toke e zakonshme, gjurmim dheu me ekskavator me goma, etj. Më tej ajo mbulon të gjitha punimet që lidhen me konstruksionin e prerjeve, largimin e materialeve të papërshtatshme në hedhurina, si dhe rifiniturat e shpatit të prerjes. Këto procese janë të parashikuara në preventiv dhe në specifikimet teknike të publikuara në SPE.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv.

Sipas VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008 të ndryshuar, kategoria **N.P – 4 A** “Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale”:

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshijnë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaj, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderrur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmëri mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse plotësuese ose pajisje erdhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventiv.

Sipas VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008 të ndryshuar, kategoria **N.P – 5 D**: Punime nëntokësore konsiderohen: ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi “hekur” kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventiv.

Sipas VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008 të ndryshuar, kategoria **N.P – 7 F** “Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje”: konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e transportimit të gazrave vajore dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse, edhe në pika të veçanta si dhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionimin normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjiellësat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimin dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura. Kjo kategori licence i referohet së pari objektit të kontratës dhe, së dyti, punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht furnizim vendosje tuba CHDPE 160, 200, 315, 400, 500, 1000 mm, puseta shkarkimi 698 copë, puseta tulle 953 copë, furnizim vendosje tuba dhe rakorderi ujëra të ndotura etj.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventiv.

Sipas VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008 të ndryshuar, kategoria **N.P – 12 E** “Punime të inxhinierisë së mjedisit”. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventiv.

Sipas VKM nr. 42, datë:16. 01. 2018 i ndryshuar, kategoria **NS - 1 A** “Punime për prishjen e ndërtimeve”, konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe, prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale, ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe, prishjeve në përgjithësi, përsi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

Kjo kategori licence, i referohet zërave të punimit të parashikuara në preventiv.

Sipas VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008, të ndryshuar, kategoria **NS-18 C** “Punime topogjeodezike.” Kjo pikë licence përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike etj. Gjithashtu është vendosur në përputhje me punimet që do të realizohen bazuar në projektin e zbatimit dhe në preventivin e punimeve. Konkretisht kjo kategori licence është e domosdoshme për piketimet e kanaleve që do të gërmohen dhe sistemimeve topografike. Është kërkuar sipas parashikimeve në relacionin teknik topografik dhe specifikimet teknike, ku kërkohet që kontraktori të marrë përsipër zbatimin e projektit inxhinierik duke bërë dendësimin e pikave të bazamentit, duke realizuar vlerat e paracaktuara të dhëna në specifikimet teknike të objektit në lidhje me saktësinë e realizimit të piketimit.

Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategoritë respektive, është kërkuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42, datë: 16. 01. 2008, të ndryshuar.

Kjo kategori licence, i referohet zërave të punimit të parashikuara në preventiv.

Sipas VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008, të ndryshuar, kategoria **NS-20 C** “Shpime gjeologjiko-inxhinierike,” puse e shpime për ujë. Përfshihen shpime për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik. Shpime për ujë dhe puse.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventiv.

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencën profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.**

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës si dhe punonjësit specialistë me certifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën 210 punonjës (përfshirë punëtorë, manovratorë, staf teknik) për periudhën e **3 (tre) muajve të fundit** duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit.

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr. 8. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

b) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, Drejtuesit Teknik si më poshtë:

- | | |
|--|-----------|
| - Inxhinier Ndërtimi (profili konstruktor/struktura) | - 2 (dy) |
| - Inxhinier Ndërtimi (profili transport) | - 1 (një) |
| - Inxhinier Hidroteknik | - 2 (dy) |
| - Inxhinier Topograf | - 3 (tre) |
| - Inxhinier Gjeolog | - 2 (dy) |

- Inxhinier Mjedisi - 2 (dy)
- Inxhinier Elektrik - 1 (një)

Drejtuessit Teknik të jenë të përfshirë në licencën e shoqërisë, të figurojnë në listë-pagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, të kenë kontratë pune të vlefshme, të deklarojnë se nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera dhe, se do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

- Operatori Ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nga Administratori i shoqërisë) **Përgjegjësin Teknik të Kantierit**, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit i deklaruar, duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara të Udhëzimit nr. 2, datë 13. 05. 2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Operatori Ekonomik, për përmbushjen e këtij kriteri duhet të përcaktojë me anë të një deklarate nga administratori i shoqërisë për personelin kryesor, Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rremë do të vepohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës sipas Shtojcës Nr. 8. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr. 285 datë: 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, për Drejtuesit Teknik duhet të dorëzojë dokumentacionin:

- Kontratë noteriale pune, e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate
- Diplomë profesionale
- CV
- Librezë pune
- Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 8734 datë: 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

Argumentimi a/b: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Gjithashtu, me qëllim ndërtimin e objektit të veprës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qenë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion, në zbatim të Udhëzimit Nr. 2 datë: 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga ana e administratorit të shoqërisë **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, të përfshirë në licencimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë: 16. 01. 2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” si dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera.

Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 210 punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, për periudhën 24 muaj, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë, (total janë parashikuar rreth 5855 m3 gërmime me krahë), drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e lartë të punimeve.

Duke qenë se ky objekt përfshin rikonstruksionin dhe ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve në zona informale, si dhe duke u bazuar në grafikun dhe llojin e punimeve që do të kryhen si: ndërtim i

linjës kryesore dhe lidhjet e familjeve, gjurmime, ngjeshje, sistemime, hidroizolime, shtrim tubacionesh, pusetat shpërndarëse, shkarkimit dhe kontrollit, punimet me krahë, mbushje etj., punime këto të cilat duhet të realizohen brenda afatit të parashikuar të objektit, në grafikun e punimeve, gjithsej 24 muaj, lind nevoja për këtë fuqi të përcaktuar punëtore.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, njësia e prokurimit referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku më hollësisht parashtrahet:

Është kërkuar inxhinier hidroteknik i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve voluminoze hidraulike lidhur me zërat e preventivave të punimeve seksioni “Punime hidroteknike”, kontrollin e gjithë punimeve që kanë lidhje me ndërtimin e linjës kryesore dhe linjave të shpërndarjes, furnizim vendosjen e tubacioneve dhe rakorderive të KUZ, përgjatë gjithë rrjetit etj.

Është kërkuar inxhinier ndërtimi i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet, për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, kontrollit të punimeve të betonit të pranishme në preventiv si: ndërtim mure betoni, pusetat beton arme, pusetat shpërndarje dhe pusetat e kontrollit etj.

Është kërkuar gjeodet/topograf, pasi sipas relacionit teknik dhe specifikimeve teknike, është parashikuar se kontraktori që do të marrë përsipër zbatimin e objektit inxhinierik, duhet të bëjë dendësimin e pikave të bazamentit, duke realizuar vlerat e paracaktuara të dhëna në specifikimet teknike të objektit, në lidhje me saktësinë e realizimit të piketimit. Nga shoqëria kërkohet dhe një azhurnim i saktë i këtij investimi në përfundim.

Është kërkuar inxhinier mjedisi, pasi ai është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që do të ndërtohet për secilin nga zërat e punimeve të mjedisit. Zbatimi i projektit nuk

duhet të ketë pasoja negative në mjedisin e zonës. Të bëhet monitorimi periodik i emetimit të zhurmave në mjedis dhe gazrave në ajër, për kanalet e drenazhimit të ujërave, rreth perimetrin të zonës së punimeve.

Është kërkuar Inxhinier Elektrik, pasi është përgjegjës për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të instalimeve dhe punimeve elektrike në kantier, është përgjegjës për mbarëvajtjen e këtij rrjeti gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës, si dhe është përgjegjës për çdo problematikë në terren, në konstatimin dhe riparimin (në rast të dëmtimeve të mundshme) të çdo rasti të shfaqur gjatë punimeve në zbatimin e plotë të kontratës.

Është kërkuar inxhinier ndërtimi, profili transport, pasi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që do të ndërtohet dhe, gjithashtu do të asistojë/ndjekë punimet për ndërtimin/kthimin në gjendjen e mëparshme të rrugëve.

Është kërkuar inxhinier gjeolog, pasi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeologjike referuar preventivit.

c. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga të paktën **42 (dyzet e dy)** punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë, dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, me profesione si më poshtë:

- 9 (nëntë) Hidraulikë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

- 4 (katër) specialist ndërtimi, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”

- 4 (katër) saldatorë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;

- 4 (katër) specialistë elektrikistë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” .

- 7 (shtatë) specialiste karpentier/muratore shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

- 2 (dy) specialistë hidroizolues, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

- 5 (pesë) hekurkthyes, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

- 1 (një) inxhinier materialesh, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

- 2 (dy) inxhinierë ndërtimi shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

- 2 (dy) teknikë gjeodet topograf shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

- 1 (një) teknik hidroteknik shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

- Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës sipas Shtojcës Nr. 8. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve, objekt kontrate.
- Diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
- Për specialistët e mësipërm të paraqiten Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 8734 datë: 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

Për punonjësit me profesionet si më sipër, Operatorët Ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni Publik/Privat, lëshues i certifikatës/diplomës	Nr. NIPT-i (në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
3				
Etj.				

Argumentimi :Janë kërkuar punonjës të specializuar dhe të certifikuar, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm, sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën;

Konkretisht janë kërkuar:

- **Teknik ndërtimi**, të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, duke pasur parasysh punime ndërtimore që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve, mur tulle për puseta, bordura betonarme etj.
- Për kërkesën për **specialist elektrikist** njësia e prokurimit është bazuar në punimet elektrike dhe të ndriçimit që do bëhen referuar projektit.
- **Punonjësit saldatorë** janë kërkuar për kryerjen e të gjitha punimeve që kanë të bëjnë me saldimin drejtimin bashkimin e detaleve të ndryshme me prerjen e tyre me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura sipas zërave të preventivit të punimeve. Këto përcaktime janë bërë edhe në specifikimet teknike të publikuara në SPE.
- **Hidraulikë**, të cilët siç parashtrua më lart, janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e të gjitha punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Konkretisht: Në specifikimet teknike, parashikohet furnizim vendosje i tubave përfshirë të gjithë mbështetësit, rakorderitë dhe mbrojtjet, pajisje shtesë për shtrimin. Cilësia e Instalimit varet në një masë të madhe nga personeli që do të bëjë këtë bashkim, dhe respektimi prej tyre i kërkesave teknike. Për këtë arsye, specialistët që do të punojnë për bashkimin e tyre, duhet të jenë të pajisur me certifikatën përkatëse për punimet hidraulike, e cila do të vërtetojë kualifikimin dhe trajnimin e tyre.
- **Specialistët hidroizolues** janë kërkuar duke pasur parasysh volumin e hidroizolimit në procesin e hidroizolimit të pusetave KUN.

- Punonjës **hekurkthyes** janë kërkuar për të realizuar kthimet e hekurit, kornizat e hekurit në armaturat e betonit në punimet e betonit. Këta punonjës realizojnë kthimet e hekurit, kornizat e hekurit në armaturat e betonit në punimet e betonit dhe shtresë betoni. Specialistët hekurkthyes presin, përkulin dhe vendosin rrjeta teli në strukturat e betonit, bëjnë planet e punës në lidhje me strukturat e hekurit dhe betonit, përgatitin shufra çeliku ose rrjeta çeliku me gjatësinë e kërkuar duke i prerë ato me mjetet përkatëse, mbledhin shufrat ose rrjetat përforcuese duke salduar, instaluar në tokë ose prerë në vende të paracaktuara brenda betonit, fabrikojnë struktura çeliku dhe vendosja e tyre si strukturë për derdhjet e betonit, etj.
- **Specialistet karpentier/murator** janë kërkuar për të realizuar punimet e armaturave në beton duke pasur parasysh volumin e punimeve me hekur beton (referuar preventivitet). Është e nevojshme për prerjen dhe montimin e strukturave prej druri, si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet.
- **Inxhinier materialesh**, që është përgjegjës për kontrollin e materialeve që do të përdoren sipas preventivitet.
- **Inxhinier ndërtimi**, që është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve, sipas zërave e punimeve ndërtimore.
- **Teknik Gjeodet / topograf**, janë të nevojshme për zbatimin e saktë të kuotave të objektit që do të ndërtohet, në funksion të realizimit të saktë të tij, si dhe realizimin e punimeve gjeodezike, sipas zërave të preventivitet të punimeve.

d. Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën:

- 8 (tetë) Manovratorë/Ekskavatoristë/Automakinistë të pasqyruar në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës sipas Shtojcës Nr. 8. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr. 285 datë: 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:

- Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme), lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor;
- Kontratë pune/shërbimi të vlefshme;
- Kartelë personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në piken 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

e. Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën : - 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare, akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë: 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 datë: 05. 05. 2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr. 285 datë: 19. 05. 2021, secili prej operatorëve ekonomikë duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) “Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë, sipas akt-marrëveshjes/kontratës së bashkëpunimit.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në nenin 39 6/c “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë, për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

f. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë, ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi/me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr. 742 date 06.11.2013, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 108, datë: 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme, duhet të disponojnë si pjesë të stafit ose të nënshkruajë kontratë shërbimi me një mjek të përgjithshëm.

2.3.4. Operatori Ekonomik të ketë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2. B “Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte”, III. 2. A.(1+2) “Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis”, I. 2. A “Mbrojtja kundër zjarrit”.

2.3.5. Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton	5	në pronësi ose me qira
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 ton	3	në pronësi ose me qira
3	Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	4	në pronësi ose me qira
4	Kamionçina me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton	4	në pronësi ose me qira
5	Kamion me vinç me kapacitet mbajtës 3.5-7 ton	3	në pronësi ose me qira
6	Autovinç me kosh	1	në pronësi ose me qira
7	Ekskavator me goma	5	në pronësi ose me qira
8	Vinç vetëlëvizës me zinxhirë	1	në pronësi ose me qira
9	Makineri Prerëse/Asfalti Sharrë Betoni	2	në pronësi ose me qira
10	Fadromë me goma	3	në pronësi ose me qira
11	Autobot uji	3	në pronësi ose me qira
12	Greider	1	në pronësi ose me qira
13	Wellpoint	2	në pronësi ose me qira

14	Autobetonierë me kapacitet 2.5 -3 m3	1	në pronësi ose me qira
15	Autobitumatriçe	2	në pronësi ose me qira
16	Vibrator betoni	3	në pronësi ose me qira
17	Rul hekur gomë mbi 15 ton	1	në pronësi ose me qira
18	Rul asfalti mbi 7 ton	2	në pronësi ose me qira
19	Autobetonierë	2	në pronësi ose me qira
20	Autopompë betoni	2	në pronësi ose me qira
21	Minifadromë	1	në pronësi ose me qira
22	GPS	2	në pronësi ose me qira
23	Total station	2	në pronësi ose me qira
24	Mini damper	1	në pronësi ose me qira
25	Detektor për linja energjie në tokë	1	në pronësi ose me qira
26	Batipal	1	në pronësi ose me qira
27	Makineri vijëzimi	1	në pronësi ose me qira
28	Rimorkiator	2	në pronësi ose me qira
29	Kokë tërheqëse	2	në pronësi ose me qira
30	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	3	në pronësi ose me qira
31	Autofshesë	1	në pronësi ose me qira
32	Makineri ngjeshëse dheu tokmak	4	në pronësi ose me qira
33	Rul me peshë deri në 1 ton	2	në pronësi ose me qira
34	Sondë për shpime horizontale në rrugë	2	në pronësi ose me qira
35	Deflektometër	1	në pronësi ose me qira
36	Asfalto shtruese	1	në pronësi ose me qira
37	Kontenier stacioner zyre	2	në pronësi ose me qira

38	Ekskavator me zinxhirë min 25 ton	2	në pronësi ose me qira
39	Autobot për pastrim kanali dhe puseta me vakum, me kapacitet min 18.000 lit.	1	në pronësi ose me qira

- Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:
Kokore + Jelekë fosforeshentë, minimumi 210 copë
Fikse zjarri të lëvizshme, minimumi 10 copë
Prozhektorë ndriçimi për natën, minimumi 5 copë
Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 10 copë
Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt, minimumi 10 copë
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, duhet të paraqitet dokument që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS, leje transporti, si dhe siguracionin e mjetit (police sigurimi) të vlefshme, dhe foto përkatëse.
- Për mjetet e siguruar me qira, të paraqiten dokumentet që vërtetojnë regjistrimin e tij, plus certifikatën e kontrollit teknik (SGS) dhe, siguracionin e mjetit, të vlefshme. Këto dokumente duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, të noterizuar, të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.
- Për mjetet e tjera që nuk janë të shënuara në regjistra publike, duhet të paraqitet kontratë noteriale e blerjes/faturë tatimore/dokument zhdoganimi të mjetit dhe, foto të tyre. Për pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal, ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi) të vlefshme.
- Për pajisjet me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt shoqëruar me akt pronësie origjinal, ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi) të vlefshme.
- Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik, duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve me targa, duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- Për autobitumatriçet, duhet të paraqitet leje transporti për mallrat e rrezikshme.

* Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe të pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti kontraktor.

*Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetë-deklorojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetë-deklarimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, objekti ka një shtrirje të konsiderueshme gjeografike, prandaj do të punohet në disa fronte pune njëkohësisht, për të kapur afatet e përcaktuara. Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe

volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Makineritë kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton, 15-20 ton, 10-12 ton, dhe **kamionçinat** me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton, 1.5-2 ton, **minidamper**, janë kërkuar për transportin e materialeve që do të dalin gjatë gërmimeve sipas kërkesave në preventiv, ku ka gërmime në volume në total dhera të gërmuara me krahë rreth 5971 m³ dhe me makineri total rreth 63246 m³ si edhe transport dheu në volume të konsiderueshme. Gjithashtu ky proces do të vazhdojë me sistemime, mbushje ngjeshje, drenazhime dhe largim të ujërave etj.

Mjetet Ekskavator me goma dhe vinç me zinxhirë, **ekskavator me zinxhirë, fadromë, mini-fadromë**, janë kërkuar sipas kërkesave të preventivit.

Makineritë autobetonierë, autopompë betoni, vibrator betoni, makineri prerëse/sharrë betoni, autobot uji, janë kërkuar duke pasur parasysh punimet në beton, të cilat janë të konsiderueshme në preventiv.

Është kërkuar pajisje Batipal, makineri ngjeshëse/**Tok Mak** për ngjeshje dheu, e cila shërben gjatë procesit të gërmimeve që përfshin preventivi i punimeve në të cilin është parashikuar mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak në disa zëra të tij. Gjithashtu referuar specifikimeve teknike ku përcaktohet: Mbushja me hedhje të dheut me makineri, është rreptësisht e ndaluar..

Autovinç me kosh, është kërkuar lidhur me shtrirjen territoriale të veprës. Nisur nga gjurma e projektit lind nevoja e autovinçit për punime në lartësi në rast nevojë në lidhje me linjat ajrore që pengojnë punën normale të mjeteve të tjera gjatë zbatimit të projektit.

Gjithashtu edhe Sistem Well Point, është kërkuar për “Largimi i ujërave nga punimet e gërmimit si pjesë e punës në zërat e gërmimit dhe jo me kosto plus për Punëdhënësin, Sipërmarrësi do të ndërtojë të gjitha drenazhimet dhe do të realizojë kullimin me kanale kulluese me pompim, ose me kova, si edhe të gjithë punët e tjera të nevojshme për të mbajtur pjesën e gërmuar të pastër nga ujërat e zeza dhe nga ujëra të jashtme gjatë avancimit të punës dhe deri sa puna e përfunduar të jetë e siguruar nga dëmtimet. Sipërmarrësi duhet të sigurojë të gjitha pajisjet e pompimit për punimet e tharjes së ujit, si edhe personelin operativ, energjinë e të tjera, dhe të gjitha këto pa kosto shtesë për Punëdhënësin. I gjithë uji i pompuar ose i drenazhuar nga vepra, duhet të hiqet në një mënyrë të aprovueshme prej Mbikqyrësit të Punimeve. Duhet të merren masa paraprake të nevojshme kundër përmytjeve. Mirëmbajtja e drenazheve mbulimi do të bëhet në mënyrë të tillë që të mos mbetet apo të akumulohet ujë në pjesët e pambushura, ose kanalet pjesërisht të mbushura. Materialet e depozituara në kanalet e rrugëve ose në rrugë të tjera ujore që ndërpriten nga linja e kanaleve, do të largohen menjëherë pas përfundimit të procesit të mbulimit, duke kthyer formën dhe përmasat e kanaleve në gjendjen e mëparshme. Drenazhimet sipërfaqësore nuk do të ndërpriten për kohë të gjatë, nëse nuk do të jetë e nevojshme”

Greider është kërkuar për hapjen dhe nivelimin e shtresave rrugore.

Sonder për shpime horizontale në rrugë është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve, shpime horizontale në rrugë.

Rul ngjeshës asfalti hekur-hekur dhe hekur-gomë për materialet e tjera, është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, siç janë shtresat rrugore.

Kokë tërheqëse dhe rimorkiator, janë kërkuar për transportin e mjeteve në kantier.

Autobitumatrice, asfalto-shtruese, është kërkuar për hedhjen e bitumit dhe primerit gjatë asfaltimit të rrugëve.

Total station dhe GPS, janë kërkuar për t'u përdorur nga topografët për zbatimin e kuotave të projektit.

Autofshesë, është kërkuar për pastrimin e rrugës nga materialet inerte, mbetje të imta, pluhura etj.

Kontenier stacioner është kërkuar si zyrë në kantier.

Deflektometer, detector për linja energjie, janë kërkuar për të parë (përcaktuar) shtresat nën tokë, para se të kryhet gërmimi. Kjo shmang rrezikun e mundshëm ndaj jetës së punëtorëve, apo të defekteve të ndryshme në ato linja.

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

Shënim: Makineritë dhe pajisjet, janë kërkuar në bazë të specifikës së punës, volumit dhe punimeve paralele në katër fronte me shtrirje të gjerë gjeografike, kjo sipas gjurmëve dhe zbatimit të projektit të miratuar për punimet në terren.

2.3.6 OE duhet të vërtetojë se zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi, në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, shëndetit dhe sigurisë në punë dhe mjedisit.

Certifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, sipas standardeve:

- **Certifikatë SSH/ ISO 9001:2015** “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit/ekuivalent dhe i vlefshëm

- **Certifikatë SSH/ ISO 14001:2015** “Për sistemin e menaxhimit të mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit/ekuivalent dhe i vlefshëm

- **Certifikatë SSH/ ISO 45001:2018** “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit/ekuivalent dhe i vlefshëm.

- **SSH/ PAS 99-2012** “Sistemi i menaxhimit të integruar”/ekuivalent dhe i vlefshëm.

- **Certifikatë SSH/ ISO IEC 27001:2013** “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit” ekuivalent dhe i vlefshëm.

-**Certifikatë SSH/ ISO 39001:2012** “**Sistemi i menaxhimit të trafikut rrugor**” ekuivalent dhe i vlefshëm.

- **Certifikatë SSH EN ISO 3834-5-2005** “**Saldim shkrirje materiale metalike**” ekuivalent dhe i vlefshëm.

- **Certifikatë SSH/ISO 50001:2018** “**Certifikim i sistemit për menaxhimin energjitik**”/ekuivalent dhe i vlefshëm.

- Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili nga operatorët duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë, bazuar në: aftësinë teknike dhe profesionale; Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore, mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti

kontraktor vlerëson se: Autoriteti kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate, në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qene në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre, për përmbushjen me sukses të kontratës.

Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarde të cilësi të cilat mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj.

Certifikatë ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

2.3.7. Afati i kryerjes së punimeve:

Afati i kryerjes së punimeve është 24 (njëzet e katër) muaj sipas Grafikut të Punimeve të publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimeve. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Argumentimi: Kjo kërkesë është bërë në bazë të nenit 15 pika 3/a të VKM Nr. 285 datë: 19. 05. 2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet: “Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”

Njësia e prokurimit referuar të dhënave teknike marre nga projekti i miratuar ku parashikohej dhe afati i kryerjes së punimeve, vendosi që afati i punimeve të jetë 24 muaj i vlerësuar si një afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumenteve të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumenteve të tenderit.

- Dokumentet u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

2.3.8 Për ato zëra punësh që nuk ndodhen në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë: 15. 07. 2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, ofertuesit duhet të paraqesin analizat teknike të tyre, sipas formatit të miratuar.

Argumentimi: Analizat teknike të çmimeve për zërat e preventivit të ofruara, janë kërkuar në funksion të formularit të ofertës, sipas shtojcës 2 “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit”, të dokumenteve standarde të tenderit për kontratat e punëve, në cilën parashikohet që çdo zë preventivi të jepet përshkrimi i analizës së kostos. Kjo kërkesë synon të garantojë autoritetin kontraktor se, ofertat e deklaruara janë të përgjegjshme dhe, se ofertuesi është i aftë të realizojë punimet në cilësinë, standardin dhe kohën e kërkuar. Këto të dhëna të deklaruara paraprakisht, i vijnë në ndihmë KVO në rast të klasifikimit të ofertave anomalisht të ulëta, për vlerësimin e tyre.

2.3.9 OE, duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator të akredituar ku të jetë përcaktuar objekti i kontratës/procedurës, për kryerjen e testeve gjatë fazës së zbatimit si dhe përfundimit të objektit. Laboratori duhet të jetë i akredituar për testet e poshtë shënuar, të certifikuar në përputhje me S SH ISO/ICE 17025:2017:

- përbërja e përzierjes së betonit/formula e mix design
- përcaktimi i konsistencës së betonit nëpërmjet testit slump
- përcaktimi në shtypje i mostrave të testimit
- metoda e kryerjes së provave pa shkatërrim të betonit – përcaktimi i shpejtësisë ultrasonik
- metodikat e kryerjes së provave pa shkatërrim të shtresave rrugore – metoda e testimit për përcaktimin e deformimeve me pajisjen Falling-Weight-Type Impulse Load Device
- metoda standard për testimin në tërësi të themeleve të thellë të betonit, me metodën ultrasonic cross hole
- metoda e provës standard për testimin e integritetit të themeleve të thellë, nëpërmjet impaktit të tensionit të ulët
- përcaktimi i pikës së zbutjes
- përcaktimi i densitetit vëllimor të mostrave të ngjeshura bituminoze
- kontrolli i përmasave
- rezistenca në tërheqje: σ_{rr} , σ_k

- përcaktimi i densitetit të korpusit
- përcaktimi i shpërndarjes granulometrike
- përcaktimi i treguesit të aftësisë mbajtëse (CBR)

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në rëndësinë e veprës, e cila është komplekse dhe e lidhur drejtpërdrejtë me popullatën dhe mjedisin përreth. Materialet e përdorura, duhet të plotësojnë kushtet minimale sipas standardeve, të cilat duhet të kalojnë disa teste laboratorike që të plotësojnë këto kërkesa.

2.3.10 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin kontratë furnizimi për tubo HDPE dhe PVC, plastike.

Sipas preventivit, kontrata e tubove të jetë e shoqëruar me kontratë furnizimi, katalogun, ISO 9001-2008, të dhënat teknike, makineritë e prodhimit të tubove, QKB, certifikata e cilësisë së provës, Kodi III.1.B (riciklim plastik), Kodi III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), Kodi III.1.B (përpunimi i plastikës).

2.3.11 Vetë-deklarim sipas deklaratës në vijim, ku të evidentohen objektet dhe vlerat përkatëse të kontratave nga OE, që brenda të njëjtës periudhë, nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % e kufirit maksimal që disponon kandidati, sipas licencës profesionale të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer nga çasti i shpallje fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në zbatim të parashikimeve ligjore të Kreut III, të VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku parashikohet:

- b) *Subjektet e licencuara në zbatim, nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nëkontraktor, një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces, për t'u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencuara, kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fitues në prokurime publike brenda të njëjtës periudhë, deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje, fjala "periudhë", kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik, nga momenti i shpalljes fitues, deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritet Kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu, me detyrimin që, kur verifikohet që subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pa vlefshme, me detyrimin për njoftim, për nisjen e procedurës për heqje licence.*

2.3.12 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Shtetit, e përcaktuar edhe te pika 2.10 e DST-ve. Financimi është parashikuar në buxhetin e shtetit 2023-2025, dhe kalon 3 (tre) vjeçarin, edhe pse afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve 24 muaj (2 vite).

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Pas hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit dhe kriterëve të kualifikimit, njësia e prokurimit, në zbatim të pikës 3 të manualit teknik "Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike", miratuar me udhëzimin nr. 7, datë: 30. 07. 2021 të APP, krijon dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit publik elektronik të APP dhe, ngarkon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për procedurën e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion dhe ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të zonave informale: Harmës; pjesërisht Krastë e Vogël, pjesërisht Lagjja: Dyli Haxhire" dhe, pjesërisht Lagjja: Katund i Ri", si dhe në zbatim të nenit 42, të ligjit ne. 162/2020 "Për prokurimin publik", vendosi si afat përfundimtar të dorëzimit të ofertave:

Data: ____/____/2023